

VENDIM
Nr. 165, datë 19.2.2020

**PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ZBATUESE PËR PROJEKTIMIN, RINDËRTIMIN
DHE RIKONSTRUKSIONIN E OBJEKTEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “iii”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti në bashkitë: Durrës, Kamzë, Kavajë, Rogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak dhe Vorë.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë.

3. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama